



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TIRANË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE  
DREJTORIA E PROKURIMEVE

**Drejtuar: Operatorit Ekonomik “ARKONSTUDIO” shpk**

**Adresa:** Njësia Nr.7 , Rruga “Frosina Plaku”, Pallati Nr.21, Shk A, Kati 3 , Ap 5, Tiranë.

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Procedura e prokurimit: “Rikonstruksioni i shkollës “Gustav Majer”**

**Numri i referencës REF-92590-11-02-2018**

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** Qëllimi i kontratës është “Rikonstruksioni i shkollës “Gustav Majer”, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit.

**Fondi limit : 8.331.432** (tetë milion e treqind e tridhjetë e një mijë e katërqind e tridhjetë e dy ) **lekë pa TVSH**

**Burimi i financimit:** Të ardhurat e Bashkisë së Tiranës vënë në dispozicion në Zbatim të Vendimit 132 datë 22.12.2017 për ”Miratimin e programit buxhetor afat mesëm 2018-2020 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2018”.

**Kohëzgjatja e kontratës:** Nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërmarrjes për zbatimin e punimeve deri në përfundimin e punimeve, 2 (dy) muaj.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 15.11.2018 Ora: 11:00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 45 datë 12.11.2018.**

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme   
Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “Euro Ndërtim” shpk me nr. NUIS, K020030010**

**Çmimi total i ofertës pa tvsh = 5.188.468** (pesë million e njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë

- 2. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “SHAMO - CONSTRUCTION” shpk me nr. NUIS L01326020F**

**Çmimi total i ofertës pa tvsh = 7.316.001** (shtatë milion e treqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e një ) lekë

- 3. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “ARKONSTUDIO” shpk me nr. NUIS L42019004I**

**Çmimi total i ofertës pa tvsh =7.740.272,1**(shtatë million e shtatëqind e dyzetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy presje një) lekë

- 4. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “KEVIN KONSTRUKSION” shpk me nr. NUIS K71401004ë**

**Çmimi total i ofertës pa tvsh = 5.874.801,44** (pesë million e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëqind e një presje dyzetë e katër) lekë.

- 5. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “ELDA-VL” shpk me nr. NUIS K67106202ë**

**Çmimi total i ofertës pa tvsh = 0 (zero) lekë.**

Janë skualifikur ofertuesit e mëposhtëm:

- 1. Operatori Ekonomik “Euro Ndërtim” shpk**
- 2. Operatori Ekonomik “SHAMO - CONSTRUCTION” shpk**
- 3. Operatori Ekonomik “KEVIN KONSTRUKSION” shpk**
- 4. Operatori Ekonomik “ELDA-VL”shpk**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

- 1. Operatori Ekonomik “Euro Ndërtim” shpk**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjate shqyrtimit te dokumentacionit te paraqitur elektronikisht nga Operatori Ekonomik **“Euro Ndërtim”shpk**, konstatoi se Operatori ekonomik nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik, pika dh,

*Së pari, AK në Dokumentat Standarte te Tenderit në Kriteret e Veçanta ka kërkuar për realizimin e kontratës si më poshtë:*

*dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

Nga verifikimi I dokumentacionit në sistemin elektronik të APP-së, rezulton se shoqëria “Euro Ndërtim” sh.p.k nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues ku të konfirmojë shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

- Refruar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, **jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.**

Operatori ekonomik “Euro Ndërtim” shpk, nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma “dh” të vendosur në DST, c’ka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se “Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.”

*Së dyti, AK në Dokumentat Standarte te Tenderit në Kriteret e Veçanta ka kërkuar për realizimin e kontratës si më poshtë:*

***Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 9).***

**Operatori Ekonomik “Euro Ndërtim” shpk ka deklaruar në shtojcën nr.9 se disponon mjetet e mëposhtëme:**

- Kamion me targa TR1598S.

*Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur për këtë mjet Autoriteti Kontraktor konstatoi se shoqëria ka paraqitur certifikatën e kontrollit teknik të mjetit e cila mban si datë të fundit të vlefshmërisë, datën 20 shtator 2018.*

*Sa më sipër mjeti nuk mund të konsiderohet i vlefshëm për shkak se ka skaduar afati i vlefshmërisë së certifikatës së kontrollit teknik.*

- Autobetonierë targa DR0134F , i siguruar me qira

*Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur për këtë mjet Autoriteti Kontraktor konstatoi se shoqëria ka paraqitur certifikatën e kontrollit teknik të mjetit e cila mban si datë të fundit të vlefshmërisë, datën 18 Tetor 2018.*

*Sa më sipër mjeti nuk mund të konsiderohet i vlefshëm për shkak se ka skaduar afati i vlefshmërisë së certifikatës së kontrollit teknik.*

- Kamion me targa DR8993E, i siguruar me qera me anë të kontratës me nr 319 rep dhe nr.116 kol e lidhur më datën 13.06.2015 dhe me afat 3 (tre) vjet me afat deri më datën 13.06.2018. *Autoriteti Kontraktor në përmbushjen e kriterit të deklarimit të mjeteve ka kërkuar paraqitjen e dokumentave si në rastin kur mjetet janë në pronësi dhe në rastin kur mjetet janë siguruar*

*nëpërmjet qerasë dhe në rastin kur mjetet janë siguruar nëpërmjet qerasë operatori ekonomik duhet të sigurohet që afati i qerasë të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Afati i realizimit të objektit të këtij prokurimi është 2 (dy) muaj, sa më sipër kontratat e qerasë e mësipërme është e pavlefshme .*

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion tre kamiona **kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 3.5 ton dhe maximum 5 ton secili kamion** për ekzekutimin e kontratës.

Operatori Ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm nuk ka paraqitur asnjë kamion me kapacitetin mbajtës të kërkuar nga AK në dokumentat standarte te tenderit

Gjithashtu AK ka kërkuar ti vihet në dispozicion **dy autobetoniera** për ekzekutimin e kontratës.

Operatori Ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm nuk ka paraqitur asnjë autobetonierë me dokumentacionin e duhur të përcaktuar në Dokumentat Standarte të tenderit.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, makineritë, pajisjet, përvojën e duhur, personelin dhe kapacitetet e duhura ekonomike e financiare, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi dhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë lidhur me kamionat me kapacitet mbajtës minimumi 3.5 ton dhe maksimumi 5 ton te kerkuar nga AK (3 copë) si dhe me mjetin Autobetonierë (2 copë), **për rrjedhojë i pavlefshëm**

***Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik i mësipërm është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik.***

*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

## **2.Operatori Ekonomik “SHAMO - CONSTRUCTION” shpk**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjate shqyrtimit te dokumentacionit te paraqitur elektronikisht nga Operatori Ekonomik **“SHAMO - CONSTRUCTION” shpk**, konstatoi se nuk plotëson, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik, pika 2.7 dhe 3

*Së pari, Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik ka kërkuar si më poshtë:*

*Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2(dy) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda nga te cilet një automakinist dhe një eskavatorist. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.*

(Për punonjësit e sipërpërmendur te paraqiten dëshmitë përkatëse të kualifikimit të sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose ekuivalente si dhe kontrata e punës (te vlefshme)

*Operatori ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur punonjësit manovrator si më poshtë cituar:*

*E.Ç manovrator(me dëshmi drejtimi të vlefshme për Buldozerist)*

*P.K manovrator(me dëshmi drejtimi të vlefshme për eskavatorist)*

*R.A manovrator (me dëshmi drejtimi të vlefshme për Buldozerist)*

***Sa më sipër Operatori ekonomik I mësipërm nuk ka paraqitur asnjë punonjës manovrator të paisur me dëshmi drejtimi të vlefshme për automakinist.***

***Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomikë i mësipërm është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik duke mos paraqitur punonjësit manovrator/ automakinist të kërkuar nga AK;***

*Së dyti, AK në Dokumentat Standarte te Tenderit në Kriteret e Veçanta ka kërkuar për realizimin e kontratës si më poshtë:*

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 9).

**Operatori Ekonomik “SHAMO - CONSTRUCTION” shpk nga deklaratimet e bëra në në shtojcën nr.9 , rezulton se:**

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion tre kamiona me **kapaciteti mbajtës minimum 3.5 ton dhe maximum 5 ton secili kamion** për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm nuk ka paraqitur asnjë kamion me kapacitetin mbajtës të kërkuar nga AK në dokumentat standarte te tenderit

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion dy kamionçina me kapacitet mbajtës minimum 1.5 ton dhe maximum 2 ton secila kamionçinë për ekzekutimin e kontratës.

**Operatori Ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm nuk ka paraqitur asnjë kamionçinë me kapacitetin mbajtës të kërkuar nga AK në dokumentat standarte te tenderit**

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, makineritë, pajisjet, përvojën e duhur, personelin dhe kapacitetet e duhura ekonomike e financiare, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi dhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

***Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik I mësipërm është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik***

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

### **3.Operatori Ekonomik “KEVIN KONSTRUKSION” shpk**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur elektronikisht nga Operatori Ekonomik “KEVIN KONSTRUKSION” shpk, konstatoi se nuk plotëson, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik, pika dh,

*Së pari, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në dokumentat standarte të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik si më poshtë cituar:*

#### ***dh. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 9;***

Nga verifikimi I dokumentacionit në sistemin elektronik të APP-së, rezulton se shoqëria “Kevin Konstruksion” shpk, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues ku, të konfirmojë shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

- Refruar Neni 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, **jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.**

Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” shpk, nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma “dh” të vendosur në DST, c’ka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se ”Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike **përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik**, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.”

Së dyti AK në Dokumentat Standarte te Tenderit në Kriteret e Veçanta ka kërkuar për realizimin e kontratës si më poshtë:

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 9).

Nga verifikimi në sistemin elektronik të APP-së mbi dokumentat e paraqitur nga operatori ekonomik I mësipërm rezulton se operatori ekonomik nuk ka paraqitur shtojcën 9 si dhe mjetet e kërkuara nga AK.

Pra sa më sipër shoqëria Kevin Konstruksion shpk nuk zotëron **kapacitet të mjaftueshem teknik** për sa i përket **mjeteve** për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: **Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....**

b) **Aftësia teknike; Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.**

Së treti, AK në Dokumentat Standarte te Tenderit në Kriteret e Veçanta ka kërkuar për realizimin e kontratës si më poshtë:

- ***Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2(dy) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda nga te cilet një automakinist dhe një eskavatorist. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.***
- ***(Për punonjësit e sipërpërmendur te paraqiten dëshmitë përkatëse të kualifikimit të sigurimit teknik lëshuar nga IQT ose ekuivalente si dhe kontrata e punes (te vlefshme)***

Operatori ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm nuk ka paraqitur asnjë punonjës të paisur me dëshmi drejtimi për automakinist apo eskavatorist.

***Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomikë i mësipërm është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik duke mos paraqitur punonjësit manovrator/ automakinist, eskavatorist të kërkuar nga AK;***

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

#### **4. Operatori Ekonomik “ELDA-VL” shpk**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, gjate shqyrtimit te dokumentacionit te paraqitur elektronikisht nga Operatori Ekonomik “**ELDA-VL**” shpk, konstatoi se Operatori Ekonomik “ELDA-VL” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën 12, të dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik “ELDA-VL” shpk s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 12, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

#### **Janë shpallur si ofertues të suksesshëm:**

- **Operatori Ekonomik “ARKONSTUDIO” shpk, kualifikohet në vend të parë.**

Çmimi total i ofertës pa tvsh = **7.740.272,1** (shtatë million e shtatëqind e dyzetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy presje një) **lekë.**

Çmimi total i ofertës me tvsh = **8.737.326,52** (tetë milion e shtatëqind e tridhjetë e shtatë mijë e treqind e njëzetë e gjashtë presje pesëdhjetë e dy) **lekë**

Afati kohor për realizimin e shërbimit është nga momenti i lidhjes së kontratës së sipërrmarjes për zbatimin e punimeve deri në përfundimin e punimeve afati 2 (dy) muaj.

- **Skualifikohet për arsyet e sipërcituara Operatori Ekonomik si më poshtë:**

#### **1. Operatori Ekonomik “Euro Ndërtim” shpk**



2. Operatori Ekonomik “SHAMO - CONSTRUCTION” shpk
3. Operatori Ekonomik “KEVIN KONSTRUKSION” shpk
4. Operatori Ekonomik “ELDA-VL”shpk

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 16.11.2018

Ankesa: Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin Ekonomik “ARKONSTUDIO” shpk me nr. NIPTI L42019004I**, me adresë: Njësia Nr.7 , Rruga “Frosina Plaku”, Pallati Nr.21, Shk A, Kati 3 , Ap 5, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme = **7.740.272,1**(shtatë million e shtatëqind e dyzetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy presje një) **lekë** , është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitörja “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1001, Tiranë, Sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) , siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar

